

RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË ILDKP PËR VITIN 2015

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjate vitit 2015, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përmbushje të misionit dhe funksionimit të tij, ka vazhduar të rrisë performancën e punës së tij, me qëllimin realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr. 9049 date 10.04.2003, "*Per deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, te Detyrime Financiare te te Zgjedhurve dhe te Disa nepunesve Publike*" i ndryshuar dhe Ligjit Nr.9367, datë 07.04.2005 "*Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike*", i ndryshuar si dhe detyrime të tjera sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, realizimi i të cilave mbështetet tërësisht në Programin Buxhetor Afatmesëm.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontrolli në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe parimet e menaxhimit financiar, me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive Konfliktit të Interesave, janë krijuar sisteme kontrolli të brendshme, të cilat janë gjithmonë në përmirësim, duke synuar drejt përmbushjes optimale të objektivave.

Në programin buxhetor të ILDKPKI, janë hartuar deklarata e misionit si dhe objektivat themelore për sigurimin e një menaxhimi eficient dhe efektiv të burimeve njërezore dhe financiare.

Gjatë vitit 2015 një nga problemet kryesore në kuadër të konsolidimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm ka qenë rishikimi i strukturës, në mënyrë që ajo të sigurojë se detyrat, hierarkia, linjat e raportimit dhe përcaktimi i aktiviteteve të kontrollit janë ndarë siç duhet në mënyrë që të sigurohet përmbushja e objektivave afatgjatë.

Gjithashtu gjatë vitit të kaluar janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e mjedisit të kontrollit nëpërmjet kontrolleve të drejtpërdrejta dhe raportimeve mujore dhe tremujore nga menaxheri i kësaj strukture.

Për periudhën në vazhdim do të jete shumë e nevojshme për më tepër kualifikime e seminare për zberthimin e ligjit, mënyrën e identifikimit dhe analizës së riskut, hartimin e gjurmës së auditit, etj, për të gjitha nivelet e punonjësve të institucioneve të ILDKPKI.

II. VLERËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në ILDKPKI, kontrolli i brendshëm është një ndër preokupimet kryesore të menaxhimit të lartë dhe trajtohet me prioritet nga Sekretari i Përgjithshëm, duke synuar një mbështetje të gjerë të gjithë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Mbeshtetur në detyrimet e përcaktuara në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe në udhëzimet e dhëna nga Njesia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, e ndjejmë përgjegjësinë për krijimin dhe monitorimin e kontrollit të brendshëm brenda strukturës që drejtojmë.

Mjedisi i kontrollit

Në ILDKPKI, mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit dhe përfshin vendosjen e objektivave që sigurojnë përmbushjen e misionit të institucionit, etiken personale dhe profesionale, strukturën organizative, filozofinë dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njëzore.

Deklarata e Misionit të ILDKPKI është hartuar dhe përmirësuar çdo vit dhe në vitin 2015 është miratuar në dokumentin e PBA në muajin Prill 2015.

Kanë përfunduar dhe janë miratuar dokumentet strategjike të ILDKPKI, dhe si pjesë perberese për arritjen e këtyre strategjive, janë hartuar dhe plan-veprimet përkatëse.

Në ILDKPKI, ekziston Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Veprimtarisë, e cila bazohet në dy ligjet mbi të cilën ushtron veprimtarinë e saj ILDKPKI si dhe në kuadrin ligjor ekzistues mbi etikën, konfliktin e interesit e t.j.

Të gjithë punonjësit janë njohur me ligjin “Per Kodin e Etikës” që në momentin e punesimit nëpërmjet testimit.

Në rregullore ekzistojnë gjithashtu përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorëve, Ndhimës Inspektorëve, çdo drejtorie e sektori si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit. Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës.

Kryesisht mjedisi i kontrollit ndikohet nga struktura organizative e cila është e miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë, nr.55 datë 29.7.2014 i ndryshuar me Vendimin nr.108, datë 21.12.2015.

GMS mbledhet në mënyrë periodike për të diskutuar dhe marrë vendime për çështje të ndryshme. Në ILDKPKI, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, janë përcaktuar Nëpunësi Autorizues si dhe Nëpunësi Zbatues dhe është njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës.

Në ushtrimin e përgjegjësiave janë të miratuara përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe kryhen vleresimet periodike të punës mbi arritjet individuale në punë. Janë bërë trajnime për ngritjen e niveli profesional nga ASPA.

Menaxhimi i Riskut

Për vitin 2015, hartimi dhe miratimi i Regjistrit të Riskut dhe i strategjisë së minimizimit të tij ka përfunduar është miratuar më 31.12.2014

Regjistri i riskut është përgatitur duke marrë për referencë, ligjin për menaxhimin financiar dhe manualit të tij si dhe duke u mbështetur në objektivat e identifikuara në PBA 2016-2018 si dhe objektivat e punës të çdo sektori/drejtorie për vitin 2015.

Veprimtaritë e kontrollit

Në ILDKPKI, ushtrohen një sërë rregullash dhe procedura veprimi që synojnë reduktimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave, të cilat kanë natyrë kontrolluese, parandaluese apo zbuluese. Gjatë aktiviteteve të ndryshme të punës kryhen kontrole të caktuara që kanë të bëjnë me ndarjen e detyrave në mënyrë që i njëjti person mos të përfshihet në të njëjtën kohë si me

miratimin ashtu edhe me zbatimin, autorizimin, saktësimin e veprimeve para kryerjes së pagesave, etj.

Për saktësimin e të dhënave të përfshira në një dokument, ushtrohet sistemi me të paktën dy firma. Urdhër shpenzimet apo kryerja e pagesave autorizohet gjithmonë pas firmës së nëpunësit zbatues dhe nëpunësi autorizues .

Drejtuuesi i Programit "Planifikim Menaxhimi, Administrim", është iniciues i hartimit të PBA-se faza e parë dhe e dytë.

Gjithashtu kryhen edhe aktivitete të kontrollit të cilat kanë të bëjnë me monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

Gjatë vitit 2015 janë ushtruar 47 kontrole periodike për administrimin e vlerave monetare dhe materiale dhe për diferencat e konstatuara janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse dhe janë bërë zhdëmtimet në afat.

Informacioni dhe komunikimi

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve (kanalet e komunikimit) të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet sipas Rregullores së Brendshme duke respektuar nivelin e hierarkisë, në mënyrë shkresore dhe elektronike. Kujdes të vecantë i kushtohet komunikimit të informacionit në formën dhe kohën e duhur në mënyrë që të përmbushen sa më mirë përgjegjësitë e punonjësve dhe manaxherëve. Në rastet e keqinformimit apo shkeljes së afateve të caktuara janë marrë edhe njoftime për tërheqje vëmendje apo masë disiplinore nga eprorët direkt NA, apo titullari i institucionit.

Informacioni dhe komunikimi lidhen gjithashtu edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në ILDKPKI. Inspektorati i Lartë disponon një sistem kritik për realizimin e objektivave institucionale dhe ruajtjen e të dhënave nëpërmjet të cilit administrohen dhe kontrollohen deklaratat e interesave private të zyrtarëve (*regjistrim, skanim, kontroll aritmetik e logjik etj*). Për këtë sistem, ka një procedurë të mirëpërcaktuar që aplikohet në mbarim të çdo dite pune (*backup i të dhënave dhe ruajtja e tij jashtë serverit*). Gjithashtu procedura backup-i janë përcaktuar dhe për deklaratat e skanuara duke i kopjuar jashtë serverit në mjete alternative si External-HDD, CD/DVD. apo dhe për sisteme të tjera si Active Directory, ISA Configuration, Cisco PIX Configuration, Sistemi i Aksesit me Karta Hyrje/Dalje etj, shumë të rëndësishëm për funksionimin korrekt të rrjetit TIK të Institucionit.

Procese pune mjaft të rëndësishme për arritjen e objektivave të Institucionit si regjistrimi, skanimi dhe Kontrolli Arimetik e Logjik i deklaratave të interesave private realizohen nëpërmjet sistemit informatik "Hidaa Cms". Ky sistem është i paisur me raporte dhe statistika që ndihmojnë në monitorimin e ecurisë së punës të punonjësit, sektorëve apo Institucionit në tërësi. Raporte dhe statistika të tjera që nuk janë të parashikuar në sistem, programohen nga Sektori i IT sipas nevojave institucionale (për këtë qëllim është zhvilluar një aplikim i vecantë - "Hidaa Reports"). Dy procese pune gjithashtu shumë thelbësore për Institucionin janë dhe Kontrolli i Plotë dhe Konflikti i Interesave. Monitorimi i progresit për këto dy procese realizohet nëpërmjet Ms-Excel. Në ILDKPKI, funksionon Sektori i Teknologjise se Informacionit si dhe përdorimi i email-t është një rrugë e mundshme për të kërkuar apo shkëmbyer informacion me të gjitha institucionet.

Monitorimi

Monitorimi kryhet nëpërmjet monitorimit dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, analizave të zbatimit të buxhetit nga Drejtuesi i Programit, Drejtoria e Financës çdo muaj, tremujor dhe vjetor apo sa herë të lind nevoja.

Për monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve përdoren një sërë procedurash nga Titullari, nëpunësi Autorizues dhe Zbatues. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, apo monitorimin e strategjive dhe objektivave.

Në ILDKPKI, nuk ka strukturë të auditimit të brendshëm.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM

Për vitin 2015, nuk ka patur auditim të brendshëm dhe të jashtëm.

IV. MASAT E MARRA GJATE VITIT PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHEM NE NJESI DHE PLAN VEPRIMI PËR TË ARDHMEN

Gjatë vitit raportues 2015, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e mjedisit të kontrollit nëpërmjet kontolleve të drejtpërdrejta dhe raportimet mujore dhe tremujore nga menaxheri i çdo strukture.

Përpjekje janë bërë dhe po bëhen edhe në hartimin e gjurmëve të auditit për procedurat standarte, sipas udhëzimeve të nxjerra në zbatim të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

V. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE NËNLIGJOR MBI SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM.

Në kuadrin e zbatueshmerisë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit të MFK-së, është e nevojshme të ketë më tepër kualifikime e seminare për zbërthimin e ligjit, mënyren e analizës së Menaxhimit të riskut si dhe të gjitha detyrimeve të tjera të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financës për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve të ILDKPKI, duke siguruar një pjesëmarrje në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, nëpunës autorizues dhe zbatues, si dhe specialistë të tjerë me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës së institucionit tonë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Flori KARAJ

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NËPUNËS AUTORIZUES

